



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANË

NR. AKTI 154

NR. VENDIMI 1851

Dt. 16.07.2019

V E N D I M

“NE EMER TE REPUBLIKES”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë

Kryesues Altin Abdiu

asistuar nga sekretare gjyqësore **Aurora Cjapi**, date 16.07.2019, përfundoi së shqyrtuari në seancë gjyqësore publike çështjen penale që u përket;

Prokuroria Prane Gjykates Se Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar nga prokurori **Agron Gjana**.

I pandehur: **Muhamet Isler**, i biri i Durmus dhe i Mynyre, i dtl.07.07.1985, lindur ne Konja,Turqi dhe banues ne Tirane, shtetesi e kombesi turke, arsim i larte, stomatolog, i martuar, i padenuar, identifikuar me karte identiteti, ne mungese, i perfaqesuar me deklarim nga av. Beqar Kocaqi, Dhoma e Avokatise Tirane.

Akuzuar: Për kryerjen e vepres penale “Prostitucioni” parashikuar nga neni 113 pg.2 i K.Penal.

Në konkluzionet përfundimtare prokurori kërkoi :

-Deklarimin fajtor te te pandehurit Muhamet Isler per kryerjen e vepres penaele “Prostitucioni” bazuar ne nenin 113/2 te K.Penal, denimin e tij me 300 000 (treqind mije) leke gjobe.

Shpenzimet proceduriale ti ngarkohen te pandehurit.

-Perfaqesuesi i te pandehurit kerkoi deklarimin e pafajshem te te pandehurit sepse nuk provohet akuza e ngritur nga prokuroria. Ne rast se gjykata e gjen fajtor, kerkojme nje denim sa me te bute me gjobe.

-I pandehuri ne mungese.

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

V E R E N

Prokuroria Prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, ka paraqitur per gjykim procedimin penal Nr. 1001 te vitit 2017, ne ngarkim te te pandehurve Enkelejda Ibro, Gazment Radaçi Rajmonda Spahiu dhe Muhamet Isler, te akuzuar perkatesisht:

-E pandehura Enkelejda Ibro, per kryerjen e veprave penale: Shfrytëzimit te prostitucionit”, parashikuar nga Neni 114/2 i K.Penal dhe “Mbajtja e lokaleve për prostitucion”, parashikuar

nga Neni 115 i K.Penal.

-I pandehuri Gazment Radaçi, per kryerjen e vepres penale "Prostitucioni", parashikuar nga Neni 113/1 i K.Penal.

-Te pandehurit Rajmonda Spahiu dhe Muhamet Isler, per kryerjen e vepres penale "Prostitucioni", parashikuar nga Neni 113/2 i K.Penal.

Me vendimin Nr.2105 Regj.Themeltar, datë 14.05.2018 te gjyqtarit te Seances Paraprake, eshte vendosur qe çeshtja te dergohet per gjykim.

Ne seancën paraprake te pandehurit Enkelejda Ibro, Rajmonda Spahiu dhe Gazment Radaçi nepermjet mbrojtjesve te tyre kane kerkuar gjykim te shkurtuar, kerkese kjo e bere konform Nenit 403 te K.Pr.Penale.

Trupi gjykues me kryesues Kujtim Vraniçi dhe anetare Lazer Sallaku dhe Erion Bani, me vendim te ndermjetem te dates 18.07.2018, ne baze te nenit 405/6 te K.Pr.Penale, kane pranuar kerkesat e te pandehurve te mesiperm per zhvillimin e gjykimit te shkurtuar dhe kane veçuar çeshtjen per te pandehurin tjetër Muhamet Isler.

Ne perfundim te procesit gjyqesor, trupi gjykues i mesiperm me vendimin nr. 2175 date 11.07.2018, i cili ka marre forme te prere, nder te tjera ka vendosur:

Deklarim fajtor të të pandehurës Enkelejda Ibro, për kryerjen e veprës penale "Shfrytëzimi i prostitucionit", parashikuar nga Neni 114/2 i K.Penal dhe në bazë të kësaj dispozite, dënimin e saj me shtatë vjet burg.

Deklarim fajtor të të pandehures Enkelejda Ibro, për kryerjen e vepres penale "Mbajtja e lokaleve për prostitucion", parashikuar nga Neni 115 i K.Penal dhe në bazë të kesaj dispozite dënim e saj me një vit burg.

Në zbatim të Nenit 55.1 te K.Penal, të pandehurës Enkelejda Ibro i caktohet një dënim i vetëm, me shtatë vjet burgim.

Në zbatim të Nenit 406/1 të K.Pr.Penale, të pandehurës Enkelejda Ibro i ulet 1/3 e dënimit dhe perfundimisht denohet me kater vjet e tete muaj burgim.

Në zbatim të Nenit 59 të K.Penal, pezullimin i ekzekutimit të dënimit me burgim duke filluar afati i proves nga e nesërmja e shpalljes sëvendimit të gjykatës.

Vënia në provë e të dënuares Enkelejda Ibro për një periudhë kohe prej 5 vjetesh me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale.

Gjatë kohës së provës e dënuara Enkelejda Ibro të mbajë kontakte me Zyrën Vendore të Shërbimit të Proves Tiranë.

Në zbatim të Nenit 60/9 te K.Penal, detyrimin e të dënuarës Enkelejda Ibro që të mos shoqërohet me persona të dënuar.

Bazuar ne Nenin 261/1/d dhe 389 te K.Pr.Penale, Gjykata urdhëron shuarjen e masës së sigurimit "Arrest shtëpie" caktuar të pandehurës Enkelejda Ibro me vendimin Nr.317/1 Akti, date 24.05.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Deklarim fajtor të të pandehurës Rajmonda Spahiu, për kryerjen e veprës penale "Prostitucioni", parashikuar nga Neni 113/1 i K.Penal dhe në bazë të kësaj dispozite, dënimin e saj me 150 000 (njëqind e pesëdhjetëmijë) lekë gjobë.

Në zbatim të Nenit 406/1 të K.Pr.Penale, të pandehurës Rajmonda Spahiu i ulet 1/3 e dënimit dhe përfundimisht dënohet me 100 000 (njëqind mijë) lekë gjobë.

Deklarim fajtor të të pandehurit Gazment Radaçi, për kryerjen e veprës penale "Prostitucioni", parashikuar nga Neni 113/2 i K.Penal dhe në bazë të kësaj dispozite, dënim

e tij me 150 000 (njëqind e pesëdhjetëmije) lekë gjobë.

Në zbatim të Nenit 406/1 të K.Pr.Penale, të pandehurit Gazmend Radaçi i ulet 1/3 e dënimit dhe përfundimisht dënohet me 100 000 (njëqind mijë) leke gjobe.

- Nga hetimi gjyqësor i çeshtjes së veçuar ndaj të pandehurit Muhamet Isler, i akuzuar për kryerjen e vepres penale "Prostitucioni" parashikuar nga neni 113/2 i K.Penale, ka rezultuar e provuar se:

Seksioni për Trafiket e Paligjshme në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë pasi ka marrë informacion në rrugë operative se në një lokal ku ushtrohej aktivitet si qendër masazhi të ndodhur në Rrugën "Jusuf Vriani" të quajtur "SPA Caliente", me pronare të pandehuren Enkelejda Ibro, ushtrohej prostitucion dhe se aktiviteti i masazhit ishte mbulesë për këtë veprim të paligjshëm.

Për këtë shkak nga ana e Seksionit për Trafikeve, janë marrë masa për mbajtjen në vëzhgim të këtij ambienti me qëllim identifikimin e personave që kryenin veprimtari të kundraligjshme si dhe sigurimin e provave të duhura për këtë veprimtari. Vëzhgimi ka filluar në orën 18:00 të datës 10.02.2017 dhe rreth orës 20:40 në këtë qendër kanë hyrë dy shtetase, të identifikuar më pas si Anxhela Bilani dhe Vergjini Çani. Pas disa minutash tek qendra e masazheve "SPA Caliente", janë futur i pandehuri Muhamet Isler, së bashku me shtetasin Ramazan Gozel dhe ka dalë nga qendra "SPA Caliente" i pandehuri Gazmend Radaçi.

I pandehuri Gazmend Radaçi, pasi ka dalë nga qendra "SPA Caliente" është marrë në pyetje nga policia dhe ai ka pranuar se ka shkuar tek qendra "SPA Caliente" edhe dy apo tre here të tjera, ku në një seancat që ka kryer i ka ferkuar organin gjeneral një vajze me emrin Xhina dhe për këtë veprim kam paguar 1000 leke të reja bakshish, përveç pagesës prej 5000 leke për masazhin.

Rreth orës 21 :00 të datës 10.02.2017 shërbimet e policisë janë futur në ambientet e brendshme të qendrës së masazheve "SPA Caliente", ku është konstatuar se në hollin e qendrës po qëndronte e ulur shtetasja Anxhela Bilani. Në një nga dhomat ndodhej i shtrirë në një krevat, pa rroba, i mbuluar me një peshqirë në pjesën intime ishte i pandehuri Muhamet Isler dhe në tualetin e kësaj dhome qëndronte e fshehur shtetasja Vergjini Çani, e dtl.07.04.2002, lidur në Himarë Vlore dhe banues në Kudhës. Në dhomën tjetër të masazhit e ndodhej i shtrirë, në një krevat, pa rroba shtetasi turk Ramazan Gozel, në këtë dhomë ndodhej dhe shtetasja Bukurije Domi. Këta persona janë shoqëruar nga policia gjyqësore në polici dhe janë marrë në pyetje. Gjithashtu shtetasja Vergjini Çani (që shkurt e therrasin Xhina) ka pranuar se është punësuar nga ana e Enkelejda Ibro tek qendra e masazheve "SPA Caliente" dhe përveç masazhit i është kërkuar nga Enkelejda Ibro që ajo të kryej dhe shërbime seksuale ndaj klientëve kundrejt pagesës dhe ajo i ka kryer këto shërbime seksuale.

E pyetur si person nën hetim dhe e pandehur shtetasja Enkelejda Ibro në prani të mbrojtësit të saj, ndër të tjera ka deklaruar se ka ndërtuar biznesin e masazhit "SPA Caliente", aty ka pasur të punësuar shumë vajza ku midis tyre citon dhe emrat e Inva Limaj, Elsa Sokoli, Rajmonda Spahiu, Anxhela Bilani dhe Vergjini Çani. Enkeljda ka shpjeguar se të gjitha vajzat kanë ofruar masazhe relaksimi përfshirë dhe Vergjininë dhe nga masazhi merrnin 1000 leke, ndërsa Enkeljda merrte 4000 leke. Gjithashtu e pandehura Enkelejda ka shpjeguar se tek ambjete të saj, e masazheve ka shkuar dhe shtetasit Gazmend Radaçi dhe Muhamet Isler dhe këtyre shtetaseve veç masazheve iu është ofruar dhe seks oral nga ana e punonjësës së saj Rajmonda Spahiu. Ndërsa shtetasja Rajmonda Spahiu e pyetur si person nën hetim dhe me

pas si e pandehur ka deklaruar se pasi është takuar me shtetasen Enkelejda Ibro, kjo e fundit i ka treguar ambientin dhe i ka sqaruar se janë tre lloje masazhesh relaksi, masazh terapi dhe masazhi erotik. Masazhi erotik kryeje pasi klienti zhvishej, zgjaste 60 minuta dhe veç masazhit trupor, klienti masturbohej. Ky proces quhej "shkarkim" dhe kushtonte 50 euro. Ndër të tjera e pandehura Rajmonda ka shpjeguar se kishte dhe një lloj tjetër masazhi që këtë e bënte nëse binte dakort dhe ishte masazh oral ku klientit i bëhej seks oral, zgjaste 10 minuta dhe kushtonte 3000 leke. Gjithashtu e pandehura Rajmoda Spahiu ka deklaruar se ka kryer shërbime seksuale në qendrën e masazhit "Caliente" si seks oral dhe masturbim kundrejt pagesave. Për këto shërbime Rajmonda Spahiu është paguar, por pjesën më të madhe të pagesës e ka marrë Enkelejda Ibro.

E pyetur si person që ka dijen për rrethanat e çështjes shtetasja Inva Limaj ka deklaruar se vec masazhit në qendër ofroheshin dhe shërbime seksuale si seks oral dhe masturbimi. Këtë fakt e ka mësuar nëpërmjet shtetasës Rajmonda Spahiu, e cila fliste hapur për shërbimet seksuale që ju ofronte klientëve. Gjithashtu e pandehura Enkelejda Ibro që ju thoshte vajzave që mos ta turpëronin, pasi klientët duhet të mbeteshin të kënaqur.

Ndersa e pyetur si person që ka dijeni për rrethanat e çështjes shtetasja Elsa Sokoli, ajo ka deklaruar se me klientët për llojin e masazhit bisedonte vete Enkelejda Ibro. Klientët vazhdimisht kërkonin shërbime seksuale si seks oral dhe masturbim, por ajo nuk i ka ofruar këto shërbime dhe ka dalë nga dhoma e masazhit më tej aty ka vijuar Enkelejda, por nuk di të sqaroj se si ka vijuar masazhi. Në lidhje me refuzimin për shërbimet seksuale ndaj klientëve, Enkelejda i thoshte Elsës se refuzimi i saj i prish punë dhe bën që të largohen klientët. Sipas Elsës, Enkelejda i thoshte se nëse do bënte masturbim do paguhej më tepër. Në lidhje me shërbimet seksuale Elsa sqaron se Enkelejda ishte vazhdimisht në kërkim të një vajze që ofronte shërbime seksuale. Nga bisedat me vajzat dhe Enkelejdën, Elsa ka mësuar se Rajmonda Spahiu ofronte shërbime seksuale dhe ishte punonjëse që sillte klientë dhe punë. Ndersa sipas deklarimeve të Elsës, Rajmonda tregonte dhe vetë për shërbimet seksuale që ofronte.

Gjithashtu ditën e ngjarjes të pandehures Enkelejda Ibro i është sekuestruar dhe aparati celular, i cili është dërguar për ekspertim kompjuterik. Nga akti i ekspertimit Nr. 7271 datë 06.07.2017, ka rezultuar se aty ka të dhëna dhe konkretisht fotografi të vajzave që kanë qënë të punësuar në qendrën e masazhit "SPA Caliente". Fotografitë janë të shtetaseve Vergjini Cani, Anxhela Bilani, Elsa Sokoli, etj, ku dallojnë dhe disa fotografi të cilat u janë bërë disa meshkujve në ambientet e qendrës së masazhit "Calinete" të ulur në kolltuk. Bie në sy fotografi të shtetasës Vergjini Cani, e cila ka dalë e vetme në shumicën e tyre, në ambiente e qendrës "Caliente" e veshur dhe me përparse të bardhë, e hapur në pjesën e përparme. Nga tekset e mesazheve rezulton se meshkujt bëjnë pyetje si, "Kë ke sot që të vij, ç'kemi. ndonjë goc të re sot shefe etj".

Rrethanat e faktit penal, u provuan në këtë gjykim me këto prova të marra dhe të verifikuara në hetimin gjyqësor:

Deshmite e deshmiteve Vergjini Çani dhe Anxhela Bilani, të cilat konfirmuan faktin se kanë kryer masazhe të ndryshme tek qendra "Spa Caliente", në pronësi të bashketepandehures Enkeledda Ibro.

Vendim i formës së prirë nr. 2175 datë 19.07.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, sipas të cilit rezulton se deshmitarja Vergjini Çani ka kryer shërbime seksuale edhe ndaj të

pandehurit Muhamet Isler, kundrejt pageses ne ambjentet e qendres se masazheve “Spa Caliente”, ne pronesi te bashketepandehures Enkeleda Ibro

Konkretisht sipas vendimit te mesiperm, pronarja e qendres “Spa Caliente”, bashkeepandehura Enkeleda Ibro, eshte deklaruar fajtores dhe eshte denuar per kryerjen e veprave penale “Shfrytezimi i prostitucionit” dhe “Mbajtja e lokaleve per prostitucion” parashikuar perkatesisht nga nenet 114/2 dhe 115 te K.Penal.

Ne gjykim perfaqesuesi i te pandehurit kerkoi deklarimin e tij te pafajshem duke pretendua se i pandehuri qe ai perfaqeson ka konsumuar elementet e figures se vepres penale “Prostitucioni” parashikuar nga neni 113/2 i K.Penal.

Persa i perket cilesimit juridik te faktit penal.

Ne nenin 113 te K.Penal me titull “Prostitucioni”, eshte parashikuar se:

“Ushtrimi i prostitucionit dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Dhenia e shperblimit per perfitim personal te prostitucionit denohet me gjobe ose me burgim gjer ne tre vjet”.

- Objekti i vepres penale: Ligjvënësi ka parashikuar një mbrojtje të posaçme, për një marrëdhënie juridike të rëndësishme, siç është ajo e vendosur nga shteti për të garantuar normat e moralit të shoqërisë, të cilat janë në kundërshtim të plotë me dukurinë negative të prostitucionit. Pra ne rastin konkret vertetohet objekti i vepres penale, ushtrimi i prostitucionit nga ana e te pandehurit Muhamet Isler, sipas nenit 113 prg.2i K.Penal.
- Ana objektive e kesaj vepre penale: I pandehuri Muhamet Isler ka kërkuar dhe përfituar shërbime seksuale nëpërmjet ofrimit dhe dhënies së shpërblimit në mënyrë të vullnetshme.
- Subjekti i vepres penale: I pandehuri eshte subjekt i pergjithshem i kesaj vepre penale, pasi ka mbushur moshen per pergjegjesi penale dhe eshte i pergjegjshem per veprimet e kundraligjshme te kryera.
- Nga ana subjektive vepra penale eshte kryer me dashje, me qellim perfitimi personal.

Persa u arsyetua me siper Gjykata i gjen te pabazuara pretendimet e mbrojtjes per deklarimin e pafajshem te te pandehurit, per shkakun se rezulton e provuar, tej çdo dyshimi te arsyeshem, bazuar ne provat e evidentuara me siper, se jane konsumuar nga i pandehuri nepermjet veprimeve te kundraligjshme elementet e figures se vepres penale “Prostitucioni” ne formen e dhenies se shperblimit per perfitim personal, parashikuar nga neni 113/2 i K.Penal.

Në caktimin e llojit dhe të masës së dënimit, Gjykata ka parasysh:

Rrezikshmërinë relativisht të lartë shoqërore të veprës penale dhe te pandehurit, per faktin se ai eshte i padenuar me pare dhe mban qendrim mohues per akuzen.

Nisur nga rrezikshmeria shoqerore e vepres penale dhe e te pandehurit, shkalla e fajit, Gjykata çmon se ai duhet denuar me 120 000 (njqind e njezete mije) leke gjobe e cila duhet te paguhet ne Zyren Permbartimore Tirane, brenda nje afati 9 (nente) mujor nga dita e marrjes forme te prere te ketij vendimi.

Meqenese i pandehuri rezultoi fajtor per vepren penale per te cilen akuzohet, ne baze te neneve 485 dhe 393 te K.Pr.Penale, ai duhet te ngarkohet me pagimin e shpenzimeve procedurale.

PER KETO ARSYE

Gjykata në zbatim dhe të neneve 379-384, 390 të K.Pr.Penale

V E N D O S I:

- Deklarimin fajtor të pandehurit **Muhamet Durmus Isler** për kryerjen e veprës penale “Prostitucioni”, bazuar në nenin 113 pg.2 të K.Penal, denimin e tij me 120 000 (njqind e njezete mijë) leke gjobe e cila të paguhet në Zyren Permbartimore Tirane, brenda një afati 9 (nente) muaj nga dita e marrjes forme të prërë të këtij vendimi.
- Shpenzimet procedurale i ngarkohen të pandehurit.
- Kundër vendimit lejohet ankim brenda 15 ditësh nga e nesërmbja e shpalljes në Gjykatën e Apelit Tirane.
- U shpall sot në datën 16.07.2019.

SEKRETARE
AURORA CJAPI

GJYQTAR
ALTIN ABDIU

